

VENDIM
Nr.521, datë 8.8.2007

**PËR PROCEDURAT E BLERJES NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË DISA MALLRAVE,
TË PËRJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 5 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mallrat, produktet dhe shërbimet, që nuk i nënshtrohen ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (neni 5) dhe që janë të nevojshme për modernizimin e Forcave të Armatosura, klasifikohen nga Ministria e Mbrojtjes, e cila përcakton:

a) llojet e armëve, të municioneve, pajimeve, pajisjeve ushtarake e materialeve luftarake dhe të shërbimeve, të lidhura me to, si dhe produktet e shërbimet, që u shërbejnë qëllimeve të mirëfillta ushtarake;

b) marrëveshjet dhe kontratat në fushën e blerjeve, që përmbajnë informacion, ekspozimi i të cilit është në kundërshtim me interesat e sigurisë kombëtare.

2. Blerjet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga Ministria e Mbrojtjes me ministrinë homologe dhe strukturat e tyre të varësisë, të vendeve anëtare të NATO-s ose me subjektet përkatëse, me të cilat këto vende realizojnë blerje për nevojat e tyre, me kushtet, çmimet e standardet, që ato zbatojnë për forcat e tyre të armatosura.

3. Procedurat me subjektet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi ose me subjekte të tjera, sipas vlerësimit të Ministrisë së Mbrojtjes, zbatohen edhe kur lind nevoja për blerje mallrash të të gjitha llojeve, në raste të veçanta, si fatkeqësi natyrore, konflikte të armatosura, operacione luftarake, stërvitje ushtarake dhe pjesëmarrje në misione ushtarake jashtë shtetit, ku marrin pjesë dhe Forcat tona të Armatosura.

4. Analiza, studimi e klasifikimi i mallrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, kryhet nga komisioni i kërkesave për sisteme e pajisje luftarake, i ngritur pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Për realizimin e procedurave për këto blerje Ministria e Mbrojtjes raporton, në mënyrë të hollësishme, në fund të çdo viti, në Këshillin e Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha